E DIEL
30 Qershor
2013

MILOSAO

e-mail: milosao2005@yahoo.com

# Ura e vjetër e Beratit dhe historia e saj

*Historia e panjohur e Urës së Kurt Pashait, pashait të Beratit që në vitin 1777 kishte financuar për ndërtimin e urës së Gorricës mbi lumin Osum dhe që e ktheu pastaj atë në të gurtë. Në vitin 1918 në mbarim të Luftës së Parë Botërore, austriakët para se të largoheshin nga Berati i vunë dinamit urës dhe prishën mesin e saj. Italianët që erdhën pas tyre vendosën pranë harkut të prishur një pasarelë të varur me kavë çeliku, e cila do vlente për kalimin e njerëzve...*



"Berati" 1813 (Gravurë, Cyrille Pavet de Courteille)

Guri Filozofal- Përse shtegtojnë dallëndyshet nga vendet që s'kanë dimër - Nga ARIAN LEKA

Krijimtari nga William Blake, Skënder Drini; Esse nga Andrew O'Hagan, Adriano Amati dhe argumente të tjera...

Redaktor: Besi Xhaçka; Grafika: Arian Bura 85

NDËRTIM

*Autori ndërton një hipotezë shumë interesantë për një urë, e cila ka ekzistuar më parë sesa ura e Gorricës. Mendojmë se kjo urë në qendër ka qenë e përbërë prej 3 harqesh të mëdhenj, të cilët krijonin pjesën horizontale paralel me nivelin e lumit dhe nga të dy krahët kishte nga 3 harqe, ku harqet sa vinin e zvogëloheshin për të dhënë edhe pendencën deri në mbështetëset anësore, që të çonin në nivelin e rrugëve nga të dyja anët e Osumit. "Njohja e monumentit, historisë së tij, vazhdimësisë së jetës së tij, specifikave të veçanta të realitetit ekzistues të monumentit, ishin shkaqet kryesore për studimin dhe paraqitjen grafike të urës së çuditshme të Beratit mbi lumin Osum me 9 harqe prej druri për kalimin e njerëzve"...*



Fig. 7

# Ura e çuditshme prej druri e shek XVI në Berat

*Njohja e monumentit, historisë së tij, vazhdimësisë së jetës së tij, specifikave të veçanta të realitetit ekzistues të monumentit, ishin shkaqet kryesore për studimin dhe paraqitjen grafike të urës së çuditshme të Beratit mbi lumin Osum me 9 harqe prej druri për kalimin e njerëzve.*

**NGA DRITAN ÇOKU**

Lagjja Goricë (fig.1) në qytetin his torik të Beratit përbën njësinë e vet me ndërtimore të ngritur në krahun e majtë të lumit Osum, pra e ndarë prej pjesës tjetër të qytetit. Ndërtimi i këtij ansambli duket se ka filluar aty rreth mesit të shekullit XVI, duke u bazuar në zhvillimin e mirë që kishte arritur kjo lagje rreth çerekut të tretë të shekullit XVII. Lagjja çdo nevojë e plotësonte në qendrën zejtaro-tregtare, sepse brenda lagjes nuk kishte një një-si të tillë. Kohë më parë ndërlidhja me këtë lagje bëhej me trap, ura druri dhe më pas ura prej guri mbi lumin Osum ose siç quhet sot Ura e Goricës.

Në revistën mujore "Diturija" të Lumo Skëndos kemi një artikull me titull "Berati Plak" me 5 korrik 1927 nga z .Gjergj Haxhi Mihali. Ai tregon se nga një libër në kishën e Shën Gjergjit mësojmë se Kurt Pasha, pashai i Beratit në vitin 1777 kishte financuar për ndërtimin e urës së Goricës mbi lumin Osum dhe e ktheu atë në të Gurtë (fig.2). Në vitin 1918 në mbarim të Luftës së Parë Botërore, austriakët para se të largoheshin nga Berati i vunë dinamit urës dhe prishën mesin e saj. Italianët që erdhën pas tyre vendosën pranë harkut të prishur një pasarelë të varur me kavë çeliku, e cila vlente për kalimin e njerëzve. (Koli Vesho, Berati qytet muze, Berat, 2012, f.143) Një investim prej 45 mijë lireta me kontributin edhe të qytetarëve beratas të cilët dhanë 10 mijë lireta, rikonstruktohet nga firma "Tamburlini" ura në lagjen Goricë e cila ishte djegur gjatë Luftës së Parë (Marela Guga, Historia e prefekturës së Beratit 1920-1939, bocet, f.266). Dëmtimet e ndryshme të saj dhe nevoja për qarkullim mbi urë në të dy drejtimet njëkohësisht ka sjellë zgjerimin e gjerësisë së saj. Kjo zgjidhje është realizuar duke zëvendësuar parapetin e urës prej guri, me parapet të krijuar, duke futur në trupin e urës shina hekuri të cilat dalin konsol, duke i inkastruar e betonuar dhe duke krijuar parapet të ri, i cili qëndron edhe sot. Ky zgjerim ka krijuar në sipërfaqen kaluese të urës dy mini trotuare në të dy krahët për kalimin e këmbësorëve. Si përfundim mund të themi se në hyrje dhe dalje të urës kemi veprën autentike origjinale, ndërsa dy qemere dhe parmakët janë rikonstruktuar në vitin 1923 dhe një këmbë dhe dy gjysëm qemere që mbështeten në të mendojmë se janë rikonstruktuar në vitin 1938 (fig.3,6).(Genci Samimi, Dritan Çoku, Jeta e një monumenti, Ura e Goricës në Berat, Pse duhet të planifikohet për restaurim, "Gazeta Shqiptare" suplementi "Milosao", 12 Dhjetor 2010) Në shtator 1944 ushtria gjermane nuk mundi të realizojnë planin për prishjen e urës në ditën që largoheshin nga Berati.

Por si ka qenë pamja arkitektonike e urës së çuditshme të Beratit mbi lumin Osum në shek.XVI-XVII ?



Fig. 7

Për ndërtimin e urës së çuditshme të Beratit mbi lumin Osum për kalimin e njerëzve shkruan udhëtari dhe kronisti i famshëm Osman Evlija Çelebi, në veprën e tij, "SEJAHATNAME", (udhëtimet) prej 10 volumesh. Ai ka të dhëna mjaft të rëndësishme dhe shumë të vlefshme për gadishullin e Ballkanit, Evropën Perëndimore, Afrikën, Azinë, etj. Në volumin e 8-të veprës së tij, ai përshkruan me rreth 12 faqe qytetin e Beratit pas vizitës të dytë të bërë në vitin 1672. Ai thotë: "Në qytetin e Beratit, aty poshtë, pas tregut të kazanxhijve, mbi lumin e Osumit gjendet një urë e madhe që shërben për kalimin e udhëtarëve karshi, në Varosh të Thatë. Gjithsej ka nëntë harqe prej druri, por themelet e urës qëndrojnë mbi këmbë prej gurësh të çuditshëm, të zhytur në ujë. Pjesa e sipërme e urës është e shtruar me material lisi (pelina). Është diçka e çuditshme saqë rrallë mundet të takohet. Në Hercegovinë, në qytetin Koxha që gjendet mbi lumin e thellë, dhe është ndërtuar në kohën e Sulltan Sulejmanit, ajo përbëhet vetëm nga një hark prej druri, kurse kjo e Beratit është e pajisur me nëntë harqe (Zoti ta ruajë!)".(Vasfi Samimi, Berati 300 vjet më parë, "Dita 2000", Tiranë, 2007, f. 38) Për kohën e ndërtimit të kësaj ure vështirë të thuhet ndonjë gjë e saktë, pasi deri më sot nuk kemi rastisur ndonjë të dhënë. Veçse një gjë është e sigurt: Ajo është ndërtuar atëhere kur ka lindur nevoja e komunikimit midis dy brigjeve të Osumit, d.m.th. i takon asaj kohe kur në të majtë të lumit filloi popullimi dhe ndërtimi i mëhallës së Goricës. Duke arsyetuar kështu, ndërtimi i këtij objekti në pikëpamje kohore, mund të vendoset, të paktën, në gjysmën e dytë të shek. XVI. (Ferit Duka, Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII), Toena, Tiranë, 2001, f.214) Madje, siç del nga defter i vitit 1583, në gjysmën e dytë të shek. XVI, ekzistonte edhe mëhalla përtej Osumit, Gorica. (Po aty, f.177)

Udhëpërshkruesi Evlija Çelebi për malin e Goricës na informon se: "Është një mal i madh, i lartë dhe i stolisur me drurë e pyje pafund. Qerestetë dhe binarët që përdoren për riparimin dhe ruajtjen e urës merren së këndejmi. Çdo njeri që guxon të presë qoftë dhe një dru të hollë nga ky pyll dënohet dhe kundrejt tij merren masa nga gjykata."(Vasfi Samimi, Berati 300 vjet më parë, "Dita 2000", Tiranë, 2007, f.37) Popullsia e krishterë vazhdonte, si një shekull më parë, të kryente disa detyra mirëmbajtjeje. Në vitin 1688, Papa Jani, Staso Jani, Bane Dhimo, nga lagjja "Kala" e Beratit deklaronin se ata vazhdonin të ishin të falur nga detyrimet e jashtëzakonshme kundrejt shërbimit të përgatitjes së materialeve e shpenzimeve për urën e qytetit. (Petrika Thëngjilli, Shqiptarët midis lindjes dhe perëndimit (1506-1839), fusha fetare 1, Maluka shpk, Tiranë, 2002, f. 245) Ashtu siç u përmend edhe më sipër me këto burime, tregohet mjaft qartë dhe flasin për veprën inxhinierike, realizimin e saj mjaft të çuditshëm, rregullat për ruajtjen, sigurimin e materialit drusor dhe për mirëmbajtjen e saj. Nga burimet e ndryshme rezulton se edhe në shek.XVIII-XIX ishin të përhapura mjaft urat e drurit, prej të cilave sot nuk kemi asnjë gjurmë. (Valter Shtylla, Disa ura të vjetra prej guri në vendin tonë, "Monumentet" 11, 1976, "Mihal Duri", Tiranë, 1976, f.223)




Fig.2



Fig.3




Fig.6

Gjatë studimit të hollësishëm të Urës së Goricës kemi realizuar një analizë të thellar të burimeve historike nga letërsia historiografike, përshkrimeve që udhëtarë të ndryshëm kanë bërë për këtë vepër inxhinierike, dokumentimin faktik të gravurave (fig.4) dhe fotove (fig.5) se si ka qenë e ndërtuar Ura e Gorricës dhe pamja e saj arkitektonike. Kemi nxjerrë në pah gjendjen fillestare të urës prej guri, përforcimet dhe rikonstruksionet që ka pësuar ajo gjatë jetës së saj deri më sot.(fig.6) Njohja e monumentit, historisë së tij, vazhdimësisë së jetës së tij, specifikave të veçanta të realitetit ekzistues të monumentit, ishin shkaqet kryesore për studimin dhe paraqitjen grafike të urës së çuditshme të Beratit mbi lumin Osum me 9 harqe prej druri për kalimin e njerëzve.

Kuptohet se sipas gjerësisë së shtratit të lumit ura është ngritur me shumë harqe. Nga ana e konstruimit të harqeve prej druri dhe anës pamore të urës mendojmë se ura në qendër ka qenë e përbërë prej 3 harqesh të mëdhenj të cilët krijonin pjesën horizontale paralel me nivelin e lumit dhe nga të dy krahët me nga 3 harqe, ku harqet sa vinin e zvogëloheshin për të dhenë edhe pendencën deri në mbështetëset anësore që të çonin në nivelin e rrugëve nga të dyja anët e Osumit. Pra, urës së çuditshme me 9 harqe prej druri, gjë e pazakontë për atë kohë i janë shtuar nga një hark për secilin krahë nga ku fillon dhe pjerrtësia graduale deri në mbështetëset anësore (fig.7). Ofrojmë këtë lloj arsyetimi për vet




Fig. 5



Fig. 8

faktin se Ura e Gorricës që trashëgojmë ne sot në dallim vetëm të materialit që është ndërtim prej guri, ka të njëjtin filozofi, ose shkollë ndërtimi të mënyrës së konstruitumit të harqeve dhe pendencës nga të dy krahët, tip mbizotërues të urës në Shqipëri dhe në gadishull, synimi kryesor i të cilit është të ngarkojë sa më pak harqet dhe ta pakësojë sa më shumë trysninë anësore që ushtrohet mbi këmbëzat. (Eqrem bej Vlora, Ditar (Nga Berati në Tomor dhe kthim), KOÇI, Tiranë, 2003, f.54) Si shembull i kësaj ngjashmërie me urën e Gurtë të Beratit mbi lumin Osum (1777) kemi edhe urën mbi lumin Shkumbin (fig.8) të ndërtuar po nga Kurt pasha i Beratit, por edhe ura të tjera. Qëllimi i urëndërtuesit është (ndoshta e ka trashëguar prej bizantinëve) duke i rënduar këmbët në të dy anët. Shumë herë, pra, gurët e fundit të harkut formojnë edhe kalldrëmin, mbi të cilin shkon rruga, e cila zbret kur mbaron harku dhe ngjitet përsëri kur fillon harku tjetër. (Johan Georg von Hahn, Studime shqiptare, IDK, Tiranë, f.117) Këmbët e urave kanë edhe vrima nga të dy anët, për të dhënë zgjidhjen e një konstrukti të lehtë, por edhe në funksion të dritareve shkarkuese gjatë vërshimit të lumenjve. Në këmbët midis harqeve, në pjesën e poshtme të tyre ashtu sikurse na ofron informacionin edhe Çelebiu ...se themelet e urës qëndrojnë mbi këmbë prej gurësh të çuditshëm, të zhytur në ujë..., mendojmë se këmbët janë trajtuar të mprehta me masiv gurësh të mëdhenj për të hapur rrjedhën e lumit dhe për t'i rezistuar prurjeve të Osumit, gjë që i ka bërë mjaft përshtypje në atë kohë edhe kronikanit. Pra, ura në shekullin XVI ka qenë me 9 harqe, 8 këmbë dhe 2 mbështetëse anësore.

Gjatë hulumtimit që kryem mbi gjurmë të urave prej druri edhe jashtë hapësirës shqiptare hasim dy ura prej druri të realizuara në Angli, dëshmi nga arti pamor. E para e realizuar në pikturë (fig.9) e punuar nga Canaletto pas vitit 1750, mbi urën e ndërtuar përgjatë lumit Thames në Walton-on-Thames në Surrey, Angli. Ura prej druri u përfundua në 1750 dhe qëndroi deri më 1783, kur ajo u shpërbë dhe u ndërtua me tulla. Dëshmia tjetër është një gravurë e cila na paraqet qytetin dhe urën Kew në Surrey (fig.10). Ura kishte 11 harqe, dy në çdo fund të urës ishin prej guri të cilët bashkoheshin me 7 harqet prej druri. Kjo urë përfundoi më 1 qershor 1759 dhe rezistoi për 30 vjet, më pas u ndërtua krejtësisht prej guri. Në realizimin grafik mbi urën e çuditshme të Beratit nga ana vizuale jam mbështetur pikërisht në dy veprat e realizuara në Angli, sepse mendojë se edhe ura e ndërtuar në Berat me nëntë harqe prej druri mbështetur në këmbë prej guri (shek.XVI) të ketë përafërsi në mënyrën e realizimit të konstruitumit të harqeve me elementet drusore. Kërkesat jetësore dhe të domosdoshme për nevoja të ndryshme një nga këto edhe ndërtimet me karakter publik bën që mjeshtrat, të cilët në dokumentet e kohës shënohen me fjalën"ustallarë" në fushën e ndërtimeve këtu edhe marangozët, veprimtaria profesionale e të cilëve nga procesi i formimit gjatë punës së tyre, përvoja etj., krijonte një shkollë në teknikën e punimit, mënyrën e ndërtimit dhe realizimit të këtyre veprave ndërtimore.

Si përfundim mendojmë se ura prej druri e shek. XVI në Berat të ketë atë mënyrë ndërtimi sipas skicës së paraqitur në këtë studim.(shih, fig.7)

Me propozimin e mësipërm të paraqitjes grafikisht të këtij ndërtimi inxhinierik nuk pretendojmë të kemi zgjidhur dhe vërtetuar përfundimisht problemin sesi ka qenë pamja dhe ndërtimi arkitektonik i urës së shek.XVI mbi lumin Osum në Berat, por mendojmë të paktën të kemi parashtruar një hipotezë. Shpresojmë që kolegët dhe koleget shqiptarë të cilët merren me kulturën materiale do të arrijnë në të ardhmen që jo vetëm të plotësojnë zbraztësinë me anë të studimeve më të thelluara mbi arkitekturën në Shqipëri, që për fat të keq vitet e fundit janë lënë pas dore, por edhe për monumente që kanë specifika të veçanta duke pasur një njohje më të plotë të arkivave, dëshmive të kohës dhe studimeve më të fundit. Jemi të hapur dhe dëshirojmë, që vërejtjet të vlejnë për një studim më të plotë të kësaj trashëgimie arkitektonike në të ardhmen, nga cilido qoftë, sidomos duke u vështruar në një kuadër më të gjerë. ***(Shënim: Rilevimi i objektit & skicat janë realizuar nga Dritan Çoku)***



Fig. 4






Fig. 10

ESSE

*Një shkrim i jashtëzakonshëm kritik për figurën e gazetarit ose si e sheh një ish-gazetar i vjetër figurën e kolegut. I thartë deri në hidhësirë, autori nuk e fal megalomaninë e profesionit tonë...Duhet të skuqemi dhe të mbyllim gojën dhe kjo të na shërbejë të shikojmë veten...*



# Gazetarët, këta injorantë të gjithëditur

**NGA ADRIANO AMATI**

Gazetarët flasin për gjithçka. Por për gazetarët kush flet?

Ngaqë për vite ma radhë kam qenë një prej tyre, më bie barra të vë kësisoj në dukje disa prej tipareve të sotme të atyre që merren me këtë profesion të nderuar, nderi i të cilit është nëpërkëmbur dhe përbaltur shpesh prej vetë gazetarëve.

E di, tanimë edhe kritika është e pamjaftueshme.

Por nëse është ende e vërtetë se autokritika, qoftë dhe forma më ironike e saj, mbetet një nga elementet e rëndësishëm të unit shoqëror të një individi, mendoj se më shumë arsye për ta bërë këtë duhet të ketë autokritikë në kohën tonë është vetë gazetari.

Pavarësisht se unë vetë, siç edhe u shpreha, kam bërë pjesë në këtë kategori për shumë e shumë vjet, madje dhe në pozicione të ndryshme (si korrespondent, zyra e shtypit dhe botues), e ndjej si detyrë të them sot dy fjalë "jo të mira" mbi sektorin aktual të informacionit.

Së pari po rendis të metat e këtij profesioni sot:

- aprovimi i gjithçkaje (thënë ndryshe kompromisi);

- keqinformimi i publikut dhe manipulimi me vetëdije i opinionit;

- frika.

Rreth të parës mjafton të kujtojmë se të gjithë gazetarët, në mënyrë stereotipike dhe me një ghë të automatizuar thonë, shkruajnë dhe pyesin gjithnjë të njëjtat gjëra. Madje shpesh here këtë shprehin në të njëjtin rend kronologjik, duke treguar një shterpësi dhe mungesë tmerruese kreativiteti.

Dikur ishte ndryshe. Gazetari ishte elokuent, përdorte me zhdërvjelltësi disa stile ligjërimesh, të cilët i zotëronte mirë, ishte spontan, improvizues dhe të kujtonte se ky zanat kishte ruajtur diçka nga stili i Demostenit apo i Ciceronit.

Përveçse pak edicionesh të rrallë, gazetarët e ditëve të sotme janë thuajse të gjithë njëlloj.

Ata madje arrijnë deri aty sa përsërisin të njëjtat fraza, në të njëjtat vende dhe me sloganët më në modë të konformizmit të shkërmoqur informativ. Perspektiva është një dhe e vetme, dhe po kështu, edhe opsioni semantik, sikur ka vetëm një pikë vështrimi dhe vetëm një mënyrë për të rrëfyer faktin.

Për t'u bindur për shterpësinë dhe mungesën e imagjinatës së gazetarëve sot mjafton të shfletosh një gazetë apo të dëgjosh një edicion informativ.

E kupton mjaft mirë se një profesion i tillë është katandisur në çështje stampash, stampa fjalish dhe personash që flasin njëlloj, modelohen njëlloj dhe që në mënyrën më qeshakake edhe ngjajnë si të qenkëshin vëllazëri e një barku.

Përsa i përket bjerrjes së dytë duhet thënë që gazetari i sotëm është i paditur (me përjashtime mjaft të rralla).

Kjo në kuptimin që kur e dëgjon teksa ai/ajo hap gojën, e kupton qartë që ky individ lexon pak ose aspak.

Dhe këtu unë e kam fjalën për librat. Pas kësaj kupton se ky njeri nuk udhëton në vende të panjohura dhe se larmia e burimeve të tij të informacionit është tepër e varfër. Këto tipare janë ndoshta më thumbueset, më dekurajueset ndër të gjithë tiparet dhe cilësitë që duhet të ketë gazetari.

Duket se atij i mungon bota dhe njerëzit e saj. Itinerari i tij është i thjeshtëzuar: redaksi, internet, zyrë, studio, kafene. Ky me gjasë duhet të jetë dhe shkaku kryesor i paditurisë gjer në injorancë të thellë dhe i aprovimit të gjithçkaje që ndodh, pa guxuar ta kundërshtojnë a t'i kundërvihen.

Kjo gjë, përveç varfërisë tematike sjell dhe shterpësi fjalori. Dhe këtu nuk bëhet fjalë për një të folur më pak elokuent.

Problemi kryesor këtu është paaftësia e gazetarëve për të diskutuar si profesionistë, si të barabartë me të ftuarin, të folurit në mënyrën e duhur dhe të qënit i mirëinformuar, me të intervistuarin.

Vërejeni një gazetar të sotëm kur interviston, kur citon, kur dialogon dhe kur ndërton një monolog. Të gjitha këto ai i bën në mënyrën më vulgare, me një mungesë parapërgatitjeje të dukshme dhe me shprehje nga më banalitet dhe më të rëndomtat të të shprehurit.

Më qesharak ai bëhet sidomos kur këmbëngul në argumentet e tij të pabazë. Në këtë pikë ai bëhet fyes, nervangritës dhe një polemizues i dështuar i çdo teme që ka marrë gjoja përsipër.

Por edhe kur ndryshon argument - duke i lënë të paprekura çështje që duhet të thelloheshin - gazetari tregon se as nuk e ka kuptuar rëndësinë e temës për të cilën është zotuar se do të flasë dhe do e trajtojë me zotësi.

Po a keni parë ndonjëherë që ndonjë gazetar të qortojë, të kritikojë a të kundërshtojë sho-shokun? Jo.

Ata vetëm shajnë, përqeshin dhe skërmiten fshehurazi.

E megjithatë, gjithçka shkon bukur, jeta e qetë është më e mirë...

***Përktheu nga italishtja Silvana Leka***